

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-151/2015

**Prishtinë,
25 tetor 2017**

Në çështjen juridike të:

K. K.

e përfaqësuar nga V. K. avokat nga Podgorica

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/239/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17909), të datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 25 tetor 2017, mori këtë

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e pas afatshme ankesa e K. K. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/229/2013, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA17909, të datës 30 Prill 2014.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 31 Janar 2007, K. K. (në tekstin e mëtejshëm referohet si: pala ankuese) ka paraqitur një Kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri-posedimin e pronës, që ndodhet në Miradi të Epërme/Gornje Dobrevo, ngastra kadastrale 1510/4 komuna e Fushëkosovës që përfshinë banesën në objektin e qujtura “stara Ekonomija” me sipërfaqe prej 40 metra katrorë (në tekstin e mëtejshëm referohet si: prona e kërkuar). Ajo shpjegoi se e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar në qershor të vitit 1999 për shkak të rrethanave që ndodhën në vitet 1998/1999 në Kosovë. Sipas palës ankuese, prona e kërkuar është uzurpuar nga I. M.

2. Së bashku me Kërkesën, pala ankuese *inter alia* dorëzoi në AKP:
 - Kopjen e listës posedues Nr.4011 lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe kadastrit në Prishtinë me 31 Tetor 1994 që deshmon se ngastra kadastrale 1519/4 ishte e evidentuar si pronë shoqerore e Ndermarjes Bujqësore “Dobrevë”.
 - Kopjen e kontratës së shitblerjes të lidhur mes palës ankuese dhe Kombinatit Bujqësor “Dobrevë” me 17 Shtator 1994 dhe e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me numër rendor Ov. Nr.8592/94.
 - Kopje letërnjoftimi lëshuar nga autoritetet e Malit të Zi në Bar me 5 tetor 2005.
3. Lënda është regjistruar me numrin KPA50654.
4. Sipas Raporteve Verifikuese të datës 27 mars 2014 dokumentat e dorëzuara nga pala ankuese, lista poseduese dhe Kontrata e shitblerjes nuk janë gjetur në arkivat përkatëse dhe verifikimi ka qenë negativ. Sipas detyrës zyrtare Sekretaria kishte gjetur shenime kadastrale se prona e kërkuar evidentohet si pronë shoqerore.
5. Prona e kërkuar është viziruar nga AKP-ja më 9 dhjetor 2010. Është gjetur se është banesë e dëmtuar, e uzurpuar. I. M. ka plotësuar formën e pjesmarjes në procedure dhe ka deklaruar se ai nuk ka pretendime ligjore përveç se është strehuar si rast social. Ai ka deklaruar se e di mirë që kjo pronë i takon Kombinatit ku ai edhe punon dhe se pala ankuese nuk ka pronësi mbi të.
6. Më 30 Prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me Vendimin KPCC/D/R/239/2014 e refuzoi kërkesën e palës ankuese. Në paragrafin 26 të Vendimit të cekur, KKPK-ja arsyetoi se pala ankuese nuk kishte arritur të paraqet prova të mjaftueshme për të treguar se ai i kishte ndo një të drejtë ligjore mbi pronën sepse ai nuk kishte paraqitur prova të cilat mund të verifikoheshin nga Sekretaria e as kërkimi sipas detyrës zyrtare nuk doli i sukseshëm.
7. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua palës ankuese më 10 Dhjetor 2014. Më 16 Janar 2015, pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së.

Pretendimi i palës ankuese:

8. Pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë ankesën e tij dhe ta ndryshojë vendimin e KKPK-së duke ia njohur të drejtat e tij mbi pronën e kërkuar. Në ankesë, ai theksoi se vendimi i KKPK-së bazohet në vërtetim të gabuar dhe të mangët të fakteve, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
9. Pala ankuese e kundërshton konstatimin e KKPK-së se Kontrata e shitblerjes së pronës së kërkuar nuk mund të konsiderohet si provë e vlefshme. Ai po ashtu nuk u pajtua me konkludimin e KKPK-së se dokumentat e paraqitura nuk gjëndeshin në arkivat përkatëse.

10. Përfundimisht ajo kërkoi nga Gjykata që ta prish vendimin e KKPK-së dhe të nxjerr aktgjykim me të cilin i njeh pronësinë palës ankuese dhe ursheron kthimin e posedimit mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

11. Ankesa është e pa afatshme në kuptim të nenit 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale parasheh se: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës”*.

12. Palës ankuese iu dërgua Vendimi i KKPK-së më 10 Dhjetor 2014, prandaj afati kohor për të paraqitur ankesë përfundoi më 9 Janar 2015. Megjithatë, pala ankuese e paraqiti ankesën vetëm më 16 Janar 2015, pra 6 ditë pas afatit të fundit. Kjo do të thotë që ankesa është paraqitur jashtë afatit kohor të parashikuar me ligj. Pala ankuese nuk ka dhënë arsye për paraqitjen e vonshme të ankesës dhe Gjykata nuk mund të gjejë ndonjë arsye për vonesën.

13. Në shkresat e lënsës shihet se pala ankuese e ka dorëzuar në zyrat e postës ankesën me 16 Janar 2015 dhe Gjykata Supreme e konsideroi si datë të dorëzimit por megjithatë kjo ishte jashtë afatit ligjor.

14. Prandaj, ankesa u desh të hidhet poshtë si e papranueshme mbi baza procedurale të Ligjit të lartcekur. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtojë bazat e paraqitura në ankesë.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it